

“PINGPONGU” ME TENDERIN 5 MILIONËSH PËR SPITALIN NË PRIZREN

SHSKUK

31 korrik 2019 SHSKUK shpall tenderin “Ndërtimi i Objektivit Spitalor për Nënë dhe Fëmijën në Prizren”.

21 tetor 2019 SHSKUK anulon tenderin duke vlerësuar të gjitha ofertat e kompanive të papërgjegjshme.

24 dhjetor 2019 SHSKUK shpallë fitues kompaninë “Raf II” pas rivlerësimit të ofertave

08 prill 2020 SHSKUK shpallë fitues kompaninë “Hidroterm” pas rivlerësimit të ofertave

24 korrik 2020 SHSKUK shpallë fitues kompaninë “Raf II” pas rivlerësimit të ofertave

30 korrik 2020 SHSKUK aprovon kërkesën e “Hidroterm” për rishqyrtim si të bazuar dhe shpallë fitues kompaninë “Hidroterm”. Kërkesa e Hidroterm për rishqyrtim të vendimit nga SHSKUK pretendonte se kjo kompani ka plotësuar kërkesën për deklaratat tatimore në ATK. “Hidroterm” poashtu potenconte se oferta e tij kishte çmimin më të lirë.

22 shtator 2020 SHSKUK publikon Njoftimin për Dhënie të Kontratës për “Hidroterm” në e-prokurimi.

30 shtator 2020 SHSKUK nënshkruan kontratën me Hidroterm.

OSHP

10 dhjetor 2019 OSHP e aprovon si të bazuar ankesën e kompanisë “Raf II” e cila pretendonte se kishte plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, që: *“kompania të ketë realizuar kontrata gjatë 3 viteve të fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro”, për të cilën arsye fillimisht ishte eliminuar. OSHP e ktheu lëndën në rivlerësim në SHSKUK.*

11 mars 2020 OSHP aprovon si pjesërisht të bazuar ankesën e kompanisë “Hidroterm”, e cila pretendonte të ketë plotësuar kërkesën e Dosjes së Tenderit, që: *“kompania të ofroj deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) për tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro”, për të cilën arsye ishte eliminuar. OSHP e ktheu lëndën në rivlerësim në SHSKUK.*

15 qershor 2020 OSHP aprovon ankesën e kompanisë “Raf II” si pjesërisht të bazuar ku pretendimi i “Raf II” ishte se “Hidroterm” nuk plotëson kërkesën për *“deklaratat tatimore në ATK për tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 8 milion euro”.*

18 shtator 2020 OSHP edhe pse aprovon ankesën e kompanisë “Raf II” si pjesërisht të bazuar, merr vendim përmes të cilit lejon SHSKUK-së të **vazhdoj me dhënie të kontratës** për kompaninë “Hidroterm”. Ankesa e “Raf II” **insistonte** që “Hidroterm” nuk kishte plotësuar kërkesën për: *“deklaratat tatimore në ATK”*

Kontrata është nënshkruar 6 ditë pas njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa sipas Ligjit për Prokurimin Publik, neni 26 pika 4.1 nënshkrimi i kontratave publike bëhet *“së paku dhjetë (10) ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës”.*